

**"KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI" SHPK**  
**RRUGA E ELBASANIT, NDERTESA Nr. 59, HYRJA 1, TIRANË**  
**NIPT K31526058G**

**VENDIM**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

**S**ot më datë 20.07.2019, ora 11:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Kolegji Universitar Luarasi" sh.p.k të ndodhur në Rruga E Elbasanit, Nd. 59, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Kolegji Universitar Luarasi" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar më 26.03.2003, me NUIS K31526058G (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

1. Shoqëria "Panorama Group" sh.a, zotërues e 100% të aksioneve të shoqërisë, përfaqësuar nga administratori z. Ardit Çela.

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Dhënien e miratimit që fitimi i realizuar i shoqërisë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;**
- 3. Të ndryshme**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" (i ndryshuar).

Për sa më sipër:

**ASAMBLEJA E SHOQËRISË**  
**VENDOSI:**



**"KOLEGJI UNIVERSITAR LUARASI" SHPK**  
**RRUGA E ELBASANIT, NDERTESA Nr. 59, HYRJA 1, TIRANË**  
**NIPT K31526058G**

1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar znj. Luljeta Hasho (Çipi), pajisur me Nr. Liçence profesionale 25 nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar, pajisur me Nr. Liçence profesionale 53 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;
2. Të japë miratimin që fitimi i realizuar i shoqërisë në vlerën prej 10,116,691 (dhjetë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) Lekë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, Z.Kino Buxheli, që personalisht apo nëpërmjet personave të autorizuar, të depozitojë këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për efekt të regjistrimit të tij në bazë të nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2008 për "QKB".

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 12:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

Shoqëria "Panorama Group" sh.a

Administrator z. Ardit Çela

*Ardit Çela*

**"PANORAMA GROUP" SHA**

**RRUGA "PANORAMA", PLL. 1, KT. 2, TIRANË**

**NIPT K22112005E**

---

**VENDIM**

**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

**S**ot më datë 20.07.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Panorama Group" sh.a të ndodhur në Rruga "Panorama", Pll. 1, Kt. 2, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Panorama Group" sh.a një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar me NUIS K22112005E (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm aksionari:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Autorizimin e Z. Ardit Çela të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. që do të mbahet më datë 20.07.2019, ora 11.00 pranë selisë së saj ndodhur në Rr. e Elbasanit, Nd. 59 H1, Kodi postar 1010, njesia Adminsitrative 2, Tiranë.**
- 2. Miratimin në tërësi të rendit të ditës të mbledhjes së asamblesë së ortakëve të Kolegji Universitar 'Luarasi' sh.p.k. si vijon:**
  - a) Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**



**"PANORAMA GROUP" SHA**

**RRUGA "PANORAMA", PLL. 1, KT. 2, TIRANË**

**NIPT K22112005E**

---

**b) Dhënien e miratimit që fitimi i realizuar i shoqërisë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;**

**c) Të ndryshme**

**3. Autorizimin e Z. Ardit Çela për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ( i ndryshuar).

Për sa më sipër:

#### **ASAMBLEJA E SHOQËRISË**

#### **VENDOSI:**

**1. Të autorizojë Z. Ardit Çela të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. që do të mbahet më datë 20.07.2019, ora 11.00 pranë selisë së saj ndodhur në Rr. e Elbasanit, Nd. 59 H1, Kodri postar 1010, njesia Administrative 2, Tiranë.**

**2. Të japë miratimin në tërësi për rendin e ditës të mbledhjes së asamblesë së ortakëve të Kolegji Universitar 'Luarasi' sh.p.k. si vijon:**

**a) Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Kolegji Universitar "Luarasi" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**

**b) Dhënien e miratimit që fitimi i realizuar i shoqërisë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;**

**c) Të ndryshme**

**3) Autorizimin e Z. Ardit Çela për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.**

**"PANORAMA GROUP" SHA**

**RRUGA "PANORAMA", PLL. 1, KT. 2, TIRANË**

**NIPT K22112005E**

---

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Z. IRFAN HYSENBELLIU**

*Irfan Hysenbelliu*  
